

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fejzullah Rexhepi kryetar, Rafet Haxhaj dhe Qerim Ademaj anëtarë, në çështjen juridike të paditësit G.M. nga fshati ..., Komuna e Podujevës, të cilin me autorizim e përfaqëson O.M. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, SH.A. Prishtinë, në çështjen për kompensim të diferencës së pagës, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur nga i autorizuari i të paditurës, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1146/12 të datës 30.06.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **24.02.2017**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET pjesërisht si e themeltë ankesa e të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës SH.A. në Prishtinë, **PRISHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1146/12 të datës 30.06.2014, si në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, sa i përket pjesës me të cilën “Obligohet e paditura Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, që paditësit t’i paguaj ndryshimin e pagës, ndryshimin e bonusit dhe trustit në mes të gradës 7 dhe 5, për çdo muaj duke filluar nga 01.02.2012 e deri në pagesën definitive, bashkë me kamatë vjetore prej 4%, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi”, si dhe sa i përket vendosjes për shpenzimet e procedurës si në pikën II, të dispozitivit të aktgjykimit dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë të shkallës së parë në rigjykim.

VËRTETOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1146/12 të datës 30.06.2014, si në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar në pjesën me të cilën është vendosur “anulohet aktvendimi i të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës nr. 01040-766/2012 i datës 07.03.2012”, ankesa e të paditurës **refuzohet si e pa themeltë**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.1146/12 të datës 30.06.2014, në pikën I. të dispozitivit ka aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpadinë e paditësit G.M. “anulohet aktvendimi i të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës nr. 01040-766/2012 i datës 07.03.2012, Obligohet e paditura Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, që paditësit t’i paguaj ndryshimin e pagës, ndryshimin e bonusit dhe trustit në mes të gradës 7 dhe 5, për çdo muaj duke filluar nga 01.02.2012 e deri në pagesën definitive, bashkë me kamatë vjetore prej 4%, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi” dhe në pikën II.

Detyrohet pala e paditur që në afat prej 7 dite nga pranimi i këtij aktgjykimi, paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumën e parave prej 165.20€.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur e paditura, për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë të aprovoj si të bazuar ankesën e të paditurës- Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, sh.a.-Prishtinë, prishet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1146/12 të datës 30.06.2014 dhe lënda ti kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje apo të ndryshohet aktgjykimi Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1146/12 të datës 30.06.2014, ashtu që të refuzohet si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit G.M..

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim me dispozitave të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi ka ushtruar padi kundër të paditurës me kërkesë për anulimin e vendimit të paditurës, me të cilin paditësit i është ulur grada nga 7 në 5, si dhe kompensimin e diferencës së pagës të ulur me këtë vendim, ndryshimin e bonusit dhe trustit në mes të gradës 7 dhe 5.

E paditura e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin se vendimi mbi uljen e gradave është i drejtë dhe i ligjshëm dhe në harmoni me autorizimet dhe kompetencat e punëdhënësit si dhe më vendimin e aksionarit Qeveria e Republikës së Kosovës për reduktimin e shpenzimeve për personelin e të paditurës.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadiës është bazuar në kontratën e punë të lidhur në mes të punëdhënësit (të paditurës) dhe punëmarrësit (paditësit) të datës 20.10.2011, në bazë të së cilës paditësit i është caktuar grada 7 si pagë bazë për punën e kryer, po ashtu aktgjykimin e ka bazuar në dispozitat e nenit 55 të Ligjit të Punës, ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës ka vendosur në bazë të nenit 452 par.1, të LPK-së.

Gjykata e Apelit nuk mund ta pranon qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në pjesën detyruese, si në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar sa i përket pjesës me të cilën “Obligohet e paditura Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, që paditësit t'i paguaj ndryshimin e pagës, ndryshimin e bonusit dhe trustit në mes të gradës 7 dhe 5, për çdo muaj duke filluar nga 01.02.2012 e deri në pagesën definitive, bashkë me kamatë vjetore prej 4%, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi”, pasi kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2, pika n) të LPK-së, pasi vendosja si në dispozitivit të aktgjykimit të atakuar dhe arsyetimi i këtij aktgjykimi është kundërthënë në mes vete.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar sa i përket pjesës detyruese, nuk ka përcaktuar vlerën monetare-dallimin në mes gradës 7 dhe 5, që duhet ti paguaj e paditura paditësit, ndonëse paditësi në padinë e parashtuar, në kërkesëpadi ka caktuar shumat mujore në shumën prej 155.50€, si kërkesë e saj për pagesë, mos caktimi i shumave me të cilat detyrohet e paditura, për dallimin në mes gradës 7 dhe 5, aktgjykimin e bën të pa qartë dhe si të tillë të pa përshtatshëm edhe për ekzekutim, që është edhe qëllimi i çdo aktgjykimi.

Dispozitivi i aktgjykimit me të cilin vendoset për kërkesën për pagesën e të ardhurave personale, për të qenë i qartë duhet të përfshijë shumat dhe periudhën për të cilën është aprovuar apo refuzuar kërkesa.

Gjykata e Apelit sa i përket vendosjes si në pikën II. të këtij aktgjykimi, me të cilën është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1146/12 të datës 30.06.2014 në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar në pjesën me të cilën është vendosur “anulohet aktvendimi i të paditurës PTK Prishtinë me nr. 01040-766/2012 i datës 07.03.2012”, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në tërësi e ka vërtetuar gjendjen faktike, në këtë pjesë aktgjykimi nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat është thirrur pala paditur si dhe në dispozitat neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e anulimit të aktvendimit të paditurës Postës dhe Telekomunikacioni i Kosovës nr. 01040-766/2012 i datës 07.03.2012, drejtë ka zbatuar ligjin material dispozitat e nenit 55 të Ligjit të Punës.

Gjykata e Apelit duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar me të cilin vendim paditësit i është ulur grada e të ardhurave personale nga grada 7 në gradën 5, konsideron se Gjykata e shkallës së parë vendimin e saj për të anuluar aktvendimin mbi caktimin e lartësisë së të ardhurave personale nr. 01040-766/2012 i datës 07.03.2012, të nxjerrë nga Kryeshefi Ekzekutiv i PTK sh.a., është i bazuar dhe ka mbështetje ligjore në bazë të neneve 10 par. 1 dhe 2, pika 2.1, nenit 11 dhe 55 par. 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, lidhur me nenin 5 të kontratës së punës e lidhur më datë 20.10.2011.

Gjykata e Apelit vlerëson se vendimi i anuluar është në kundërshtim me dispozitat e ligjore–nenin 55 par. 1, të ligjit të punës ku parashihet “i punësuarit ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me kontratën e punës, në pajtim me këtë ligj, kontratën kolektive, aktin e brendshëm të punëdhënësit” dhe në kundërshtim me nenin 5 të kontratës së punës nr. 01-2880-2016/2011 të datës 20.10.2011, shprehimisht është paraparë se “të punësuarit i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin në lartësi të gradës 7, sipas vendimit të bordit të përkohshëm të drejtorëve të PTK nr.01-1630/05 datës 28.02.2005, së paku një herë në muaj e cila nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale”.

Gjykata e Apeli vlerëson se gjendja faktike e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, sa i përket vendimit për anulimin e vendimit, duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë dhe se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar sa i përket anulimit të aktvendimit mbi caktimin e lartësisë së të ardhurave personale nr. 01040-766/2012 i datës 07.03.2012, sepse paditësi dhe e paditura raportet e tyre, të drejtat dhe detyrimet e tyre punëdhënës-punëmarrës i kanë rregulluar me kontratë të shkruar, duke përcaktuar saktë të drejtat dhe detyrat e tyre reciproke, në pajtim të plot me dispozitat ligjore të Ligjit të Punës, se kushtet e kontratës së punës janë lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës duke marr për bazë edhe lartësia e pagës-përkatësisht gradës së të ardhurave personale sipas së cilës do të paguhet paga e punëtorit për punën e kryer.

Gjykata e Apelit vlerëson se është parim i së drejtës se palët me vullnetin e tyre të lirë të shprehur apo me veprime konkludente mund të krijojnë raportet juridike gjegjësisht marrëdhënie juridike, palët me vullnetin e tyre të shprehur apo me veprime konkludente mund të ndryshojnë apo të shuajnë një marrëdhënie juridike- raport juridik.

Në rastin konkret Gjykata e Apelit konstaton se kontrata e punës e lidhur në mes paditësit dhe të paditurës ka mundur të ndryshohet vetëm me vullnetin e shprehur të të dyja palëve, dhe se e paditura nuk ka mundur të ndryshoj kushtet e kontratës vetëm me shprehjen e një anshme të vullnetit të saj dhe se aktvendimi për ndryshimin e lartësisë së gradës, duke e zvogëluar gradën e pagës bazë, siç e ka bërë e paditura, është i pa drejtë dhe në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore të ligjit të Punës dhe në kundërshtim të plotë me nenin 5 të kontratës së punës dhe se një aktvendim i tillë nuk mund të pranohet si pjesë e kontratës së punës, gjersa të dyja palët nuk pajtohen për ndryshimin e kushteve të kontratës, e cila duhet apo është dashur të bëhet me ankesë-kontratë, apo kontratë të re, e jo siç ka bërë e paditura me aktvendim me shprehje të një anshme të vullnetit.

Pretendimi ankimor i të paditurës se me paditësin kanë lidhur kontratë të re të punës nr.01-2280-2016/12 të datës 01.06.2012, ku paditësit i është caktuar grada 5, e njëjta nuk është në shkresat e lëndës, por nëse kjo kontratë është lidhur ka efekt të veprimit nga data e nënshkrimit, por jo në mënyrë retroaktive, por ky fakt duhet të provohet në ri procedurë.

Pretendimi i të paditurës se në bazë të nenit 5 të kontratës së punës aktvendimi për uljen e gradës është i ligjshëm, është i pa bazë, pasi në bazë të këtij neni (neni 5 i kontratës së punës) punëdhënësi ka ruajtur të drejtën e caktimit të vlerës së gradës (koeficientit), por jo edhe uljen e gradave, pasi e njëjta është caktuar me kontratë, pra ka mundur ta ulë vlerën e koeficientit.

Gjykata e Apelit sa i përket pretendimit të paditurës se ka qenë e detyruar të veproj në bazë të vendimit të dt.06.12.2011 të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në bazë të cilit ka konstatuar se kërkesa e aksionarit Qeveria e R. Kosovës-Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka qenë ulja e shpenzimeve operative për personelin e të paditurës në raport me të hyrat e përgjithshme të PTK-së për vitin 2012, e cila duhet të jetë jo më shumë se 20%, e cila kërkesë nuk ka qenë kërkesë e uljes së gradës së të ardhurave personale dhe si e tillë nuk ka mundur që të bëhet në mënyrë të një anshme, siç e ka bërë e paditura në rastin konkret për çka edhe vendimi i kontestuar është i pa drejtë dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata e Apelit vlerëson se është i pa bazuar pretendimi i të paditurës se gjykata e shkallës së parë se me nxjerrjen e aktgjykimit, është aplikuar në mënyrë të gabuar neni 87 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, pasi në rastin konkret mbrojtja gjyqësore është paraqitur mbrenda afatit të këtij neni, ku përcaktohet “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”, ndërsa pretendimi se është dashur të aplikohen dispozitat e nenit 78 dhe 79 të ligjit të punës, është i pa bazuar pasi kemi të bëjmë vetëm me kërkesë të shprehur në para.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, pas administrimit të provave dhe vlerësimit të pretendimeve të palëve në procedurë, duhet të vendos në atë mënyrë që dispozitivi të jetë i qartë dhe të përmbaj kërkesën e palës paditëse, ashtu që duhet të përfshijë edhe vlerat monetare si dhe periudhën e saktë, për të cilën është vendosur sipas kërkesës për pagesën e të ardhurave personale.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitave të nenit 195.1 pika c) dhe d) lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4268/2014 me datë 24.02.2017

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Fejzullah Rexhepi